

Treating and Controlling Head Lice

Trajtimi dhe Mbajtja nën kontroll e Morrave të Kokës

Kur fëmijët frekuentojnë shkollën, shumë familje vijnë në kontakt me merrat e kokës. Ky informacion do t'ju ndihmojë që t'i trajtoni dhe t'i mbani nën kontroll merrat e kokës.

Kapja e Morrave të Kokës

Morrat e kokës ekzistojnë prej shumë kohësh. Morrat e kokës mund të gjenden tek cilido, dhe nëse i jepet mundësia ata mund të transferohen pa dallim.

Morrat e kokës janë insekte të vogla, pa krahë dhe gjak thithëse. Ngjyra e tyre mund të ndryshojë nga ngjyrë kafe e hapur në kafe me nuanca të kuqe. Morrat e kokës mund të jetojnë vetëm tek njerëzit. Nëse largohen prej kokës, ata vdesin shumë shpejt, zakonisht brenda 24 orësh.

Njerëzit i marrin merrat e kokës nëpërmjet **kontaktit flokë me flokë** me një person tjetër që ka morra koke. Kjo mund të ndodhë kur njerëzit luajnë, përqafohen ose punojnë afër njëri tjetrit.

Morrat e kokës nuk kanë krahë ose këmbë për të kërcyer nga njëra kokë në tjetrën. Ata vetëm zvarriten.

Zbulimi i morrave të kokës

Shumë morra nuk shkaktojnë kruajtje prandaj ju duhet **që të kërkonti me kujdes** për t'i gjetur.

Morrat e kokës gjenden në fijet e flokëve dhe lëvizin drejt lëkurës së kokës.

Ata kanë gjashtë këmbë që përfundojnë me kthetra dhe kështu ata bien shumë rrallë prej kokës. Thërrijat e kokës janë të vendosura 1.5cm prej lëkurës dhe janë të ngjitura mirë pas fijeve. Ato i ngajnë zbokthit të kokës, por nuk mund të hiqen me krehër.

Morrat mund të zvarriten dhe të fshihen. Mënyra më e mirë dhe më efektive për t'i gjetur është ndjekja e hapave të mëposhtëm:

Hapi 1. Lyejini flokët e **thatë, e të krehur (shimpleksur)** me çfarëdo lloj 'conditioner' për flokë. Kjo i trulllos merrat dhe ia vështirëson kapjen pas flokëve apo kthimin rreth e rrotull.

Hapi 2. Pastaj krehini flokët pjesë pjesë me një krehër me dhëmbë të imëta, ose me krehër për morra.

Hapi 3. Pastrojeni 'conditioner' prej krehërit me një letër.

Hapi 4. Kontrollojeni letrën dhe krehërin për morra dhe thërrija.

Hapi 5. Përsëriteni krehjen për çdo pjesë të kokës të paktën 4 ose 5 herë.

Nëse gjeni morra ose thërrija atëherë duhet t'i trajtoni flokët e fëmijës.


Nëse nuk keni shumë kohë që e keni trajtuar fëmijën, dhe gjeni vetëm thërrija të zbrazëta, nuk ka nevojë që ta përsërisni trajtimin, pasi thërrijat bosh mund të jenë mbeturinat e një infektimi të mëparshëm.

Thërrijat

Thërrijat janë të vogla dhe në formë veze (me madhësinë e një majë gjilpëre). Një thërrijë e gjallë 'kërcen' nëse vendoset mes thonjve.

Thërrijat e ngordhura kanë anë të rrudhura dhe thërrijat e çelura ngajnë si vezë të vogla të ziera pa pjesën e sipërme.

Për rezultate sa më të mira, ju duhet të hiqni sa më shumë vezë që të mundeni.



Krehërat e Morrave të Kokës

Krehërat me dhëmbë të gjatë, të rrumbullakët prej çeliku, të vendosur afër njëri tjetrit janë më efikasët, por mund të përdoret çdo lloj tjetër krehëri morrash.

Trajtimi i Morrave të Kokës

Përqëndrohuni në kokë- nuk ka asnjë provë që të sugjerojë se ju duhet të pastroni shtëpinë ose klasën.

Produktet për morrat e kokës duhet të vendosen **në të gjitha pjesët e kokës dhe lëkurës së kokës.**

Asnjë trajtim nuk i zhdok të gjitha thërrijat, prandaj trajtimi duhet të bëhet dy herë me shtatë ditë diferencë.

Qëllimi i trajtimit të parë është që të vrasë të gjitha morrat, i dyti që të vrasë thërrijat e reja që kanë çelur brenda gjashtë ditëve të mëvonshme.

Mbulojini sytë e personit, me peshqir për shembull, ndërkohë që e lyeni me trajtim.

Nëse përdorni locione, atëherë produkti duhet të vendoset në flokët e tharë.

Nëse përdorni shampo, atëherë lageni kokën, por përdorni sa më pak ujë që të mundeni.

Vendoseni trajtimin sa më afër lëkurës që të jetë e mundur, me anë të një krehëri normal për t'i mbuluar fijet e flokëve nga rrënja në majë. Përsëriteni këtë disa herë derisa të mbuloohen të gjitha flokët.


Nëse vendosni të mos përdorni një insekticid atëherë metoda e 'conditioner' dhe krehërit mund të përdoret çdo dy ditë derisa të mos gjenden më morra të gjallë për dhjetë ditë.

Nuk ka nevojë që trajtohet e gjithë familja, veçse nëse edhe ata janë të infektuar.

Vetëm këllëfët e jastëkëve kanë nevojë për trajtim të veçantë; ose të lahen me ujë të nxehtë (të paktën 60°C) ose të thahen duke përdorur tharësen e rrobave në programin e ngrohtë ose të nxehtë.

Cikli i jetës së Morrave të Kokës

Pediculus humanus capitis



Testimi i Rezistencës

Produktet e morrave i përkasin një rres prej kategorive të mëposhtme në varësi të një përbërësi aktiv që përmbajnë:

Pyretrinat

Pyretroidet sintetike (permetrin dhe boialletrin)

Organofosfatet (maldison ose malation)

Pyretrina barishtore, me ose pa veti natyrore (jo-kimike)

Rezistenca ndaj insekticideve është e zakonshme prandaj ju duhet t'a provoni nëse morrat kanë ngordhur. Nëse po atëherë, përsëriteni trajtimin pas shtatë ditësh më të njëjtin produkt. Nëse morrat nuk kanë ngordhur, atëherë morrat janë rezistentë ndaj produktit dhe të gjitha produkteve të ngashme që përmbajnë të njëjtin përbërës aktiv. Lajeni produktin dhe trajtojeni sa më shpejt që të mundeni me një produkt tjetër që ka një përbërës tjetër aktiv. Nëse insekticidi funksionon atëherë, morrat duhet të kenë ngordhur brenda 20 minutash.

Çdo produkt i morrave të kokës mund të shkaktojë reaksione prandaj duhet të përdoret me kujdes me gratë shtatzanë ose që kanë fëmijë në gji, me fëmijët nën 12 muaj dhe me njerëzit me alergji, azëm apo me plagë të hapura në kokë. Nëse nuk jeni i sigurt verifikojeni këtë me Farmacistin apo Doktorin tuaj.

Më shumë informacion

Informacioni në këtë pamflet bazohet në punën kërkimore të bërë dhe shkruar prej Profesor. Rick Speare dhe grupit të shkencëtarëve në School of Public Health and Tropical Medicine (Shkolla e Shëndetit Publik dhe Mjekësisë Tropikale), James Cook University. Faqja e tyre e internetit është:

<http://www.jcu.edu.au/school/phtm/PHTM/hlice/hlinfo1.htm>

Më shumë informacion mund të gjendet në faqet e mëposhtme të internetit:

<http://www.dhs.vic.gov.au/phb/headlice/index.htm>

prodhuar prej Victorian Department of Human Services (Departamenti Qeveritar i Viktorias për Shërbimet Humane), Janar 2001 (0500101)

Parandalimi i Morrave të Kokës

Nuk ka asnjë produkt që të parandalojë morrat e kokës. Përdorimi i metodës së krehërit dhe 'conditionerit' një herë në javë ju ndihmon që të kuptoni që herët praninë e ndonjë morri dhe të minimizoni problemin. Lidhja e flokëve të gjata mund të ndihmojë parandalimin e përhapjes së morrave të kokës.

Rregulloret

Fëmijët me morra koke, sipas Rregullores së Shëndetit (Sëmundjet Infektive) janë të përjashtuar nga shkolla, çerdhja derisa të fillojë trajtimi. Një fëmijë me morra koke mund të trajtohet në mbrëmje dhe të kthehet në shkollë të nesërmen, edhe pse mund të ketë disa thërrija.